REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 286/19
Datë/Datum. 20.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Akt Përcjellës

Për:	- Zyrtarit Përgjegjës: Ministria e Shëndetësisë - Parashtruesin e ankesës: OE NTP "Medica" ShPK	Kopje:	Paneli Shqyrtues në OSHP, Arkives në OSHP
Prej:	Visar Bibaj – Ekspert shqyrtues i prokurimit _____; Kreshnik Spahiu – Ekspert i jashtëm teknik _____;		
Lënda:	Raport i ekspertit shqyrtues/teknik, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE - NTP "Medica" ShPK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit"Furnizim me Material Shpenzues nga Lista Esenciale për FSSH", me numër të prokurimit206-19-24-111, publikuar nga Autoriteti Kontraktues –Ministria e Shëndetësisë		
Datë	20.06.2019		

Të nderuar,

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/L-092, ju njoftojmë me raportin e ekspertit shqyrtues/teknik lidhur me ankesën me numër 286/19 të datës 07.06.2019, parashtruar nga OE - NTP "Medica" SH.P.K-Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Material Shpenzues nga Lista Esenciale për FSSH", me numër të prokurimit 206-19-24-111, publikuar nga Autoriteti Kontraktues(AK) – Ministria e Shëndetësisë (MSH)

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit, përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojë sipas kërkesave të Nenit 115 të LPP-së.Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë
- Panelit Shqyrtues në OSHP
- OE ankues -NTP "Medica" SH.P.K
-

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Raporti i Ekspertit Shqyrtues – Teknik

	14.06.2019	14.06.2019	20.06.2019
Nënshkrimi i ekspertitshqyrtues / teknik	*Data e autorizimit të Ekspertit shqyrtues / teknik*	*Data e fillimit të ekspertizës*	*Data e dorëzimit të raportit*

Neni 99 i LPP-së; Baza ligjore e shqyrtimit

Me datë 07.06.2019, OE - NTP "Medica" ShPK, - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP kundër vendimit të AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Material Shpenzues nga Lista Esenciale për FSSH", me numër të prokurimit 206-19-24-111, publikuar nga AK – MSH.
Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti shqyrtues/teknik ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore sipas nenit 3, te LPP-së.

Neni 109 i LPP-së; Operatori Ekonomik - NTP "Medica" ShPK

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues:

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 71 i LPP-së
Neni 18 i RRUOPP
Neni 27 i RRUOPP
Neni 108A i LPP-së

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet

OE NTP "Medica" ShPK, pas pranimit te vendimit lidhur me kërkesën për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit për Furnizim me Material Shpenzues nga Lista Esenciale për FSSH 206-19-24-1-1-1 nga AK - Ministria e Shëndetësisë me datën 31.05.2019 në afatin ligjor paraqet ankesë kundër këtij vendimi.

OE NTP "Medica"ShPK, si palë e interesuar lidhur me aktivitetin e Furnizim me Material Shpenzues nga Lista Esenciale për FSSH 206-19-24-1-1-1 pas pranimit të dokumentit për Tenderues të pasuksesshëm ka bërë kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare. Me datë 5.05.2019 kemi pasur qasje në dokumentet zyrtare të OE-konzerciumit te rekomanduar pe kontratë Raymend dhe Kosovamed dhe gjithashtu te OE-konzerciumit Kosovamed Healthcare dhe Olgun Medical Insaat.
Në afatin ligjor kemi paraqiturkërkesënpër rishqyrtim dhe atë me datë 17.05.2019, ndërsa me datë 31.05.2019 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesënpër rishqyrtim.

Gjatë qasjes në dokumentacionin zyrtare të Grupeve te OE të cekur me lartë, kemi hasur në disa dokumente të cilat po të identifikoheshin me kohë, do te sillnin në eliminimin e grupit të OE të rekomanduar për kontratë.
Në kërkesën për rishqyrtim kemi specifikuar të gjitha këto pretendime të cilat Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kriterin e specifikimit teknik të rekomanduar për kontratë dhe po ashtu pretendime të tjera.

Njeri prej dokumenteve kryesore i cili dëshmon se grupi i OE te rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kriteret e përcaktuar nga vet AK në FTD është deklarata e tyre ku citojmë:

- Raymed ShPK do te instalon dhe lidhe printerët ne pajisjet ekzistuese, nëse AK jep qasje direkte në pajisjet ekzistuese (paswordat dhe informatat që japin qasje direkte në konfigurim e sistemit apo pajisjen ekzistuese).

Ndërsa në dosjen e tenderit tek Specifikimet Teknike të Detyrueshme është kërkuar ndër të tjera.

- OE janë të obliguar të instalojnë dhe lidhin printerët në pajisjet ekzistues.

Pra, sipas deklaratës së Grupit të OE Raymend dhe Kosovamed, këta nuk kanë obligim të bëjnë lidhjen e printerëve në pajisjet ekzistueses ashtu siç është kërkuar në dosjen tenderit, pra nuk do ta përmbushin njërin prej obligimeve kryesore të përcaktuar nga AK, ndërsa AK për të mundësuar lidhjen në këta printer do të duhet të paguan shtesë për çdo licence të marre nga prodhuesit e këtyre pajisjeve. Pra sipas kësaj deklarate ky Grupi i OE te rekomanduar për kontrate nuk do të jenë në gjendje të përmbushin obligimin e tyre kontraktual siç është e përcaktuar në dosjen e tenderit

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME

- OE janë te obliguar te instalojnë dhe lidhin printerët ne pajisjet ekzistuese

Pra me këtë rast AK ka bërë shkelje të Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, ku ne mënyrë të saktë është përshkruar se
4. Autoriteti kontraktues do te konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjale është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Ndërsa po ashtu ky lëshim nuk mund të konsiderohet si devijim minimal apo paqartësi, pasi që kjo mungesë apo deklarim nga ana e Grupit të OE-së citojmë

- Raymed ShPK do te instalon dhe lidhë Printerët në pajisjet ekzistuese, nëse AK jep qasje direkte në pajisjet ekzistuese (paswordat dhe informatat qe japin qasje direkte në konfigurim e sistemit apo pajisjen ekzistuese).

Ka edhe ndryshim material, pasi qe AK do të ketë obligim të siguron qasjen në çdo pajisje.

Shkelja nga ana e AK te nenit 59.4, duke e rekomanduar një Grup te OE te cilët janë të papërgjegjshëm, ndërlidhet me shkeljen e nenit Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik dorëzuar ose

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çminim më te ulët.

Gjithashtu gjate qasjes ne dokumenta zyrtare kemi vërejtur se Groupi i OE i rekomanduar për kontrate ka lidhshmëri me Grupin e OE Kosovamed Helathcare dhe Olgun Medical Insaat i cili po ashtu ka ofertuar për të njëjtin aktivitet të prokurimit. Ketë pretendim e bazojmë se sipas dokumenteve të biznesit pronar i OE Kosovamed Healthcare është Kastriot Asllani ku gjithashtu në ISO 9001 të OE Raymend tek pjesa e Raportit të ISO 9001 në 4 raste përmendet ketë rast kemi te bëjmë se nga te njëjte persona (pronar) është ofertuar me kompani të ndryshme duke rënë në kundërshtim me LPP.

Kjo paraqet shkelje të nenit 71 Grupet e Operatoreve Ekonomik dhe Operatoret e Huaj Ekonomik ku citojmë:

2. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që se bashku me tenderin e tij te dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtareve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Te gjitha autoritetet kontraktuese duhet në dosjet e tyre të tenderit. Ne rast se një anëtar merr pjesë përkatëse do te konsiderohen te papërshtatshëm.

Për të njëjtën çështje flet edhe paragrafi 5 i nenit 27 të Rregullave dhe Udhëzuesi Për Prokurimi Publik.
27.5 OE-te nuk lejohen te prezantojnë një tender si individual dhe si anëtare te një grupi ne te njëjtën kohë në një aktivitet të prokurimit. Grupi OE nuk do te modifikohet pas dorëzimit e tenderit (fazës se vlerësimit), nëse ndodhë kjo atëherë tenderi do të refuzohet. Nëse gjate fazës se ekzekutimit tërhiqet njeri anëtar i grupit, përbërja e grupit nuk mund te ndryshohet pa pëlqimin e AK. Ne ketë rast AK duhet te shqyrtoj nëse kriteret e përzgjedhjes vazhdojnë te përmbushen.

Po ashtu gjate qasjes ne dokumente zyrtare kemi vërejtur Grupi i OE te rekomanduar në Kontratë të gjitha dokumentet e dosjes së tenderit si Deklarate nën Betim, Kontratat e Konzorciumit dhe gjithë dokumentacioni tjetër i kërkuar në dosjen e tenderit është nënshkruar nga 2 persona që nuk janë Pronar/Drejtor/Përfaqësues në Dokumentet e Biznesit apo nuk është paraqitur Autorizim nga ana e Pronarit për këta 2 persona (Lek Kastrati i cili ka nënshkruar ne emër te kompanisë Raymed dhe Nderim Kerleshi i cili ka nënshkruar ne emër te kompanisë Kosovamed) për nënshkrimin e këtyre dokumenteve.

Lidhur me ketë kemi kontaktuar KRPP-ne te cilët na kane informuar se KRPP ka nxjerr dhe ka publikuar ne ueb-faqen e KRPP-së gjegjësisht ne linkun ndihmesë "Pyetjet e shpeshta" një interpretim ligjor si ne vijim.

40. Si të veprohet në rastet kur dosja e tenderit , pëfrshirë deklaratat nën betim dhe dokumentet tjera të dosjes së tenderit nënshkruhen në emër të Operatorit Ekonomik ofertues nga një person i pa autorizuar.?

Po ashtu KRPP ka bere edhe interpretim për te njëjtën pike ku citojmë:

Te drejtën e nënshkrimit nga një person në emër të një personi tjetër në dosjen e tenderit dhe deklaratat nën betim pa një autorizim nga personi kompetent, nuk e rregullon Ligji për Prokurimin Publik dhe as

legjislacioni dytësor i Prokurimit Publik. Megjithatë, derisa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik (dhe jo nga një person që nuk është kompetent dhe nuk ka autorizim për ta bërë një gjë te tille), KRPP, konsideron se, nënshkrimi "për" në emër të përfaqësuesit te OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tille, nuk mund të jetë i pranueshëm.
Për të njëjtën çështje flet edhe paragrafi 3 i nenit 18 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operative Për Prokurimi Publik. Paragrafi 3 i nenit 18 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operative Për Prokurimi Publik përcakton si ne vijim:
"...Ne rast se personi që nënshkruan dhe dorëzon ofertën nuk është personi kompetent për nënshkrim te ofertës (drejtori i kompanisë), por është i autorizuar nga OE, OE duhet qe te dorëzoj me ofertën e tij autorizimin për nënshkrim te ofertës, përndryshe oferta e tij do te refuzohet. AK obligohet qe ketë kërkesë ta përcaktojë ne DT.
Pra bazuar ne dispozitat e lartë përmendura KRPP, konsideron se nënshkrimi "për" ne Formularët standard te Dosjes se Tenderit përfshire deklaratën nen betim dhe dokumentet tjera, nga një person i pa autorizuar (pra jo kompetent) nuk mund te jete i pranueshme.

Te gjitha këtë pretendime te cilat janë cekur me larte kane rezultuar me shkelje te nenit 7 Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi, ku paragrafi I e përcakton Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë te barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyre transparente.

Prandaj duke u bazuar ne faktet e paraqitura me larte AK ka rekomanduar për kontrate një grupe te OE te cilët kane bere këto shkelje
Grupi i OE te rekomanduar për kontrate nuk i ka përmbushur kriteret e FDT-se Aneksi SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME pika OE janë te obliguar te instalojnë dhe lidhin printerët ne pajisjet ekzistuese Ndërsa deklarata c Grupit te OE thotë RaymedShPK do te instalon dhe lidhe Printerët ne pajisjet ekzistuese,nëse AK jep qasje direkte ne pajisjet ekzistuese (paswordat dhe informatat qe japin qasje direkte ne konfigurim e sistemit apo pajisjen egzistuese).

Por AK-ja do te ketë obligim ti siguron dhe ti paguan te gjitha licenca për qasje ne këto pajisje, pasi qe Grupi i OE është deklaruar se nuk i siguron ato ani pse e ka obligim ligjor këtë, pra këtu do te ketë edhe ndryshim material dhe shpenzime shtese ani pse A specifikuar

2. Ku njeri pronar ka i biznesit i cili ka ofertuar ne po te njëjtin aktivitet te prokurimit, gjendet ne dokumentacionin e një biznesi (ofertuesi) tjetër dhe ne ato dokumente i referohet Menaxher.

3. Duke e pranuar si te përgjegjshëm një Grup te OE, ku te gjitha dokumentet janë nënshkruar nga ana e personave jo kompetent për nënshkrim te ofertës (drejtori i kompanisë) dhe te cilët po ashtu nuk është prezantuara snjë autorizim nga OE se kane ketë te drejt.

Por edhe përkundër se kemi specifikuar ne mënyrë shume te kjart te gjitha pretendimet vit i kemi faktuar ato, AK pas 14 dite merr vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duke i dhëne arsyetimet e tyre, te cilat nuk kane fare te beje me ankesën e paraqitur.

Me poshtë po i paraqesim arsyetimit e AK ku citojmë:

1. Pretendimet tuaja ankimore për piken nr 1 nuk qëndrojnë pasi qe grupi i OE te rekomanduar për Kontrate ne ofertën e tij ka deklaruar qe do te instaloj dhe lidhe printerët ne pajisen ekzistuese, nëse AK jep qasje direkte ne pajisjet ekzistuese, por ne te njëjtën deklarate ka deklaruar: Raymed SHPK ne afat prej 30 ditëve do te bene liferimin, instalimin dhe lëshimin ne pune te printerëve (aty ku është e nevojshme dhe kërkese e AK).

Pra këtu AK nuk e shqyrton fare kërkesën tone, por jep arsyetimi sipas dëshirës se tyre.

Te nderuar ne kuadër te FDT-se tek Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TÉ DETYRUESHME citojmë:

OE janë te obliguar te instalojnë dhe lidhin printerët ne pajisjet ekzistuese.

Pas lidhjes se kontratës OE duhet qe në afat prej 30 ditëve te bene liferimin instalimin dhe lëshimin në pune te printerëve.
Ne SHSKUK gjinden gjithsej 31 Printer qe shprehin nevojat kuantitative për printer dhe filma te cilët OE duhet i ofrojnë dhe është specifikuar ne mënyrë shume te kjart secili lloj i printerëve dhe vendi ku gjinden
Pra këtu është specifikuar ne mënyrë shume te kjart numri i printerëve te cilët do te liferohen, vendet e liferimit dhe nuk i është lënë AK te vlerëson se ku do ti instalon si dhe është kërkuar nga OE te kryejnë instalimin dhe lëshimin ne pune, ndërsa edhe njëherë po e citojmë deklaratën e OE te rekomanduar për kontrate:

Raymed ShPK do te instalon dhe lidhë Printerët ne pajisjet ekzistuese, nëse AK jep qasje direkte ne pajisjet ekzistuese.

Pra sipas kësaj ju si AK duhet ti siguroni qasje në çdopajisje ekzistuese, ne te kundërtën ky si OE nuk ka asnjë obligim pasi qe vetëm se ju ka paralajmëruar se kur do ti instalon printer.
Po e potencojmë edhe njëherë se pasi qe printeri është pajisja kryesore e cila përdoret për shfrytëzimin e filmave dhe pamundësia e lidhjes se printerit do te thotë se kjo kontrate nuk mund te realizohet pasi qe nuk do te ketë mundësi si te shpenzohen këta filma, ndërsa ne anën tjetër ne momentin qe AK-MSH do te hyni ne obligime kontraktuake,AK-MSH do te janë te obliguar te porositin min 70 % te sasisë se përcaktuar me kontrate , ku nëse AK - MSH nuk i siguron këto kode siç e ka cekur OE i rekomanduar për kontrate atëherë si do te shpenzohet kjo sasi?
Pra pretendimi te cilin ne jemi ankuar dhe arsyetimi i AK-MSH, nuk ka lidhshmëri njëra me tjetrën, qe do te thotë se fare nuk e kane shqyrtuar pretendimin nr. 1 .

Pretendimi 2. AK prapë nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë pretendimin tonë, pasi që përgjigjen e AK thuhet se AK ka kërkuar ISO dhe jo raporte Auditimit, kurse pretendimi jonë është se në raportin vlerësues në bazë te cilit është certifikuar OE me ISO ne minimum 4 raste shkruhet edhe emri i pronarit te OE Kosovamed healthcare si pjese e menaxhmentit te kompanisë Raymed. Pra kjo dëshmon se këta janë grup i lidhur .

Pretendimi 3. AK ne përgjigjen e ti kthen se pas sqarimeve te kërkuara OE ka dorëzuar kontratën e punës për dy personat qe kane nënshkruar ne dokumentet e OE. Prape ne ketë rast nuk ka shqyrtuar ne mënyrë te drejt pretendimin tone, pasi qe ne një as një rast nuk kemi pretenduar qe këta 2 persona nuk janë punëtore te OE, por kemi pretenduar se nuk figurojnë ne Certifikatën e biznesit si pronar/ drejtor apo agjent te regjistruar apo nuk është paraqitur as një autorizim nga ana e Pronarit se këta dy persona ka te drejte te nënshkruaj dokumentacionet për këtë aktivitet te prokurimit siç parashihet ne baze te LPP Po ashtu AK pretendon se ka kërkuar sqarime nga OE, ne deklarojmë se ne momentin kur kemi kërkuar qasje ne dokumentacionin zyrtar, ku kjo date ka qene pas njoftimit për dhënie te kontratës, nuk na është prezantuar fare këto dy dokumente aoi se është kërkuar ndonjë sqarim shtese.

Krejt ne fund deklarojmë se pas paraqitjes se kërkesës për rishqyrtim, AK ka bere shkelje te nenint 108A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ku ne mënyrë shume te kjart është specifikuar se
6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtoje kërkesën brenda tre (3) dite pune nga data e dorëzimit te aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtese dhe dokumenteve te parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike te justifikuara mund te zgjatet për jo me shumë se tre (3) ditë shtese, dhe ankuesi do të informohet për ketë.

Andaj duke marr parasysh faktet e paraqitura me larte kërkojmë nga OSHP qe ankesën ta aprovon si te bazuar dhe ta kthej lenden ne rivlerësim dhe te marr për bazë pretendimet tone dhe Grupin e OE te rekomanduar për kontrate te eliminohet si i papërgjegjshëm ne baze te dëshmive te paraqitura.

Procesi i prokurimit

- Data e publikimit të njoftimit për kontratë: 28.01.2019
- Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur
- Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....Furnizim / Vlerë e madhe
- Vlera e parashikuar e kontratës:.....430.740,00 €
- Kriteri për dhënie të kontratës.....Çmimi më i ulët
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....15.03.2019
- Data e kërkesës për rishqyrtim.....17.05.2019
- Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....31.05.2019

Kriteret për vlerësim

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Një deklarate e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.
2. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para publikimit të Njoftimit për dhenje të Kontratës].
3. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën Betim.
2. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore - vetëm për fituesin para dhënies se kontratës, kopje.
3. Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente - vetëm për fituesin para dhënies se kontratës (origjinal ose kopje e noterizuar).

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose në regjistrin e kompanisë në vendin tuaj të themelimit.
2. Regjistrimi ne regjistrin Fiskal.

3. Certifikata për TVSH për secilin partner te një grupi operatoresh ekonomik – kjo vlen vetëm për kompanitë e regjistruara ne Kosove ose deklarues vullnetar i TVSH-se.
4. Operatori ekonomik duhet te dëshmoj se është i regjistraur ne AKPPM si qarkullues me shumicë i pajisjeve mjekësore.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Certifikata e biznesit – kopje.
2. Certifikata e Numrit Fiskal – kopje.
3. Certifikata e TVSH-së - kopje.
4. Licenca nga AKPPM si qarkullues me shumice i pajisjeve mjekësore (me validitet).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori ekonomik duhet te dëshmoj se prodhuesi është i certifikuar me ISO 9001 2015.
2. Operatori ekonomik duhet te dëshmoj se prodhuesi është i certifikuar me CE certifikate.
3. Vërtetimi nga prodhuesi që do t'a mbështet Operatorin Ekonomik ofertues së paku 5 vitet në vijim me pjesë rezervë.
4. Operatori ekonomik duhet te jete i certifikuar me ISO 9001 2015.
5. Operatori ekonomik duhet te dëshmoj se është i autorizuar nga prodhuesi, për tenderin përkatës.
6. Kërkohet qe operatori ekonomik te prezantoj katalogun (broshurën) e pajisjeve te ofruara.
7. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuar me sukses në tri vitet e fundit deri ne njoftimi për kontrate minimum 300.000.00 euro furnizime te ngjashme.,

Dëshmitë e kërkuara dokumentare

1. Certifikata ISO 9001 2015 për prodhuesin - Kopje.
2. Certifikata ISO 13485 për prodhuesin - Kopje.
3. CE certifikate për prodhuesin - kopje.
4. Certifikata ISO 9001 2015 për OE - Kopje.
5. Autorizim nga prodhuesi për tenderin përkatës (me te dhëna mbi prodhuesin adresa, nr. tel, email, web faqja etj, për mundësi te verifikimit). Kërkohet Origjinal ose kopje e noterizuar.
6. Operatori ekonomik te prezantoj katalogun (broshurën) e pajisjeve te ofruara dhe te nënvizohen ne mënyre te qarte produktet dhe specifikat teknike te ofruara.
7. Listën e kontratave për furnizimet te ngjashme ne tri vitet e fundit, Duke bashkangjitur Referencat ose Raportet e pranimit.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike

Loti	Nr.	Emri i Operatorit Ekonomik	Vendi	Çmimi
Lot 1	1	Grup i Operatoreve Ekonomik: "Raymed" ShPK.; "KosovaMed" ShPK, Rr.B, Banesat Royal, Hyrja 14/15, Nr.12,	Prishtinë	114,780.60 €
Lot 1	2	Grup i Operatoreve Ekonomik "KosovaMedHealthcare" ShPK; "OLGUN MEDİKAL İNŞAAT TİC.LTD.ŞTİ" Rr.	Prishtinë	148,335.00 €

		MuharremFejza, Komp.Royal, Hy.C15/13, Nr.4,		
Lot 1	3	NPT "Medica" ShPK, rr.Ahmet Krasniqi,	Prishtinë	128,898.00 €
Lot 1	4	UNI - CARESH.P.K. KALABRIA RR.REXHEP KRASNIQI L.A Bll.C2 OBJ.B NR.2A,	Prishtinë	191,137.32 €
Lot 2	1	Grup i Operatoreve Ekonomik: "Raymed"ShPK.; "KosovaMed" ShPK. , Rr.B, Banesat Royal, Hyrja 14/15, Nr.12,	Prishtinë	28,715.40 €
Lot 2	2	Grup i Operatoreve Ekonomik "KosovaMedHealthcare" ShPK; "OLGUN MEDİKAL İNŞAAT TİC.LTD.ŞTİ" Rr. MuharremFejza, Komp. Royal, Hy.C15/13, Nr.4,	Prishtinë	58,824.00 €
Lot 2	3	NPT "Medica" ShPK, rr.Ahmet Krasniqi,	Prishtinë	54,180.00 €
Lot 2	4	UNI - CARESH.P.K. KALABRIA RR.REXHEP KRASNIQI L.A Bll.C2 OBJ.B NR.2A,	Prishtinë	68,545.44 €

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues

AK, ka caktuar komisionin për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve në përbërje prej tre (3) anëtarëve, si në vijim:

1. Dr.Sadik Kelmendi - Kryesuese
2. Alban Thaqi - Anëtar
3. Dr.Bujar Imeri- Anëtar

Data e mbarimit të vlerësimi:.....23.04.2019
Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari i prokurimit:.....29.04.2019

Raporti i komisionit vlerësues

Në bazë të dokumenteve të ofruar komisioni i vlerësimit rekomandon për kontratë konzorciumin Raymed – KosovaMed.
Ndërsa dy kompanitë janë me çmim me të lartë se kompania e rekomanduar për kontratë.
Ndërsa kompania "UNI – CARE"ShPK,është e papërgjegjshme për shkak se i mungojnë referenca 7.Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar me sukses ne tri vitet e fundit deri ne njoftimi për kontrate minimum 300.000.00 euro furnizime te ngjashme.

Analiza dhe konstatimet e Ekspertit shqyrtues / teknik

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues /Ministria e Shëndetësisë (MSH), gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike (kornizë – 12 muaj) me vlerë të madhe. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës.

Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës OE "Medica" ShPK, me datën 17.05.2019, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK – MSH, me pretendimet e njëjta ankimore si në OSHP, përderisa AK – MSH, me datën 31.05.2019, përmes përgjigjes, ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimore. nr. 1 (Neni 113) OE ankues pretendon që OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbush kërkesën e AK-së që e obligon të instalojë printerët pasi që ka kërkuar qasje direkte në pajisje si dhe username dhe password për të bërë instalimin dhe kjo përbën ndryshim material apo devijim sipas OE ankues.

Eksperti teknik sqaron se pasi që printerët duhet të instalohen në pajisjet e AK-së përkatësisht njësive spitalore të specifikuar si në dosjen e tenderit është evidente që për instalimin e tyre, janë të domosdoshme kredencialet (username dhe password) që kanë autorizim për të bërë instalimin (zakonisht kredencialet e Administratorit), kjo pjesë e deklaratës nuk e ndryshon materien e kërkesës, mirëpo e kushtëzon teknikisht instalimin duke potencuar nevojën për sigurimin e qasjes adekuate me nivel të autorizimit përkatës, për të bërë instalimin, transferimin e fajllave programor të pajisjes periferike, në këtë rast printerëve dhe komunikimin respektiv ndërmjet pajisjeve për të kryer funksionin. Andaj, bazuar në sqarimin e mësipërm, pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimet ankimore:nr. 2. OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrate ka lidhshmëri me grupin e OE "Kosovamed Helathcare" dhe "Olgun MedikalInşaat" dhe kjo bie në kundërshtim me LPP, përkatësisht nenin 71, pasi që z. Kastriot Asllani është pronar i kompanisë "Kosovamed Helathcare" dhe menagjer operacional tek kompania "Raymed".

Sipas shkresave të lëndës rezulton që emri i njëjtë i z. Kastriot Asllani, të jetë i përshkruar tek informatat e biznesit dhe përmes shkresave tjera, (edhe pse nuk mund të konfirmohet nëse bëhet fjalë për të njëjtin person, pasi që nuk kishim të dhëna tjera) tek kompania "Kosovamed Helathcare", dhe "Raymed" (Kosovamed Helathcare" dhe "Olgun MedikalInşaat", kanë ofertuar në grup). Sipas paragrafit 2, të nenit 71, të LPP-së, përcaktohet se, *nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet që ta parashtrojë këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit. Në rast së një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm.*

<u>Përgjigje në pretendimet ankimore:nr. 3.</u> OE ankues pretendon se AK MSH ka bërë shkelje duke pranuar si të përgjegjshme ofertën e OE të rekomanduar për kontratë pasi që dokumentet janë nënshkruar nga ana e personave jo kompetent për nënshkrim të ofertës dhe te cilët po ashtu nuk kanë prezantuar asnjë autorizim nga OE se kanë këtë të drejtë.

Sipas ofertës së OE, përkatësisht tek informatat e biznesit të kompanisë "Kosovamed" shpk dhe "Raymed"shpk, (të njëjtat kompani kanë dorëzuar ofertë në Grup) ku në te dy kompanitë sipas të dhënave në certifikatën e biznesit si, pronar është z. Xhavit Asllani, përderisa oferta dhe marrëveshja e themelimit rë Grupit – Konzorciumit, është lidhur nga persona tjetër përkatësisht nga Leke Kastrati dhe Nderim Kerleshi, ndërsa në ofertë nuk kemi hasur që të njëjtit kanë qenë të autorizuar që të krijojnë dhe dorëzojnë oferte. Sipas nenit 18.3, të Rregullave të UOPP-së, përcaktohet që "...*Në rast se personi që nënshkruan dhe dorëzon ofertën nuk është personi kompetent për nënshkrim të ofertës (drejtori i kompanisë), por është i autorizuar nga OE, OE duhet që të dorëzoj me ofertën e tij autorizimin për nënshkrim të ofertës, përndryshe oferta e tij do të refuzohet. AK obligohet që këtë kërkesë ta përcaktoje në DT.*

Mendimi i ekspertit shqyrtues/teknik

Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti shqyrtues / teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues – NTP "Medica" ShPK - Prishtinë të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa propozimi për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.